

**Nr. Prot. 053/B/18**

## VENDIMI Nr. 1253

**Për**

### **Vazhdimin e Procesit të Analizës së tregjeve 'Tregjeve me Pakicë dhe ato të Interkoneksionit në Rrjetet e Telefonisë Fikse'**

Në mbështetje të Ligjit për Komunikime Elektronike Nr. 04/L-109, neni 10 paragrafi 5), neni 31, paragrafi 1), paragrafi 3.3), paragrafi 4 dhe paragrafi 8) (*tutje referuar si; Ligji*), Rregullores Nr. 27 për Analizat e Tregut, (Ref. Nr. Prot. 039/B/14), neni 3, paragrafët 1), 3.3.3), paragrafi 4) dhe paragrafi 13) dhe neni 4 paragrafi 3) (*tutje referuar si; Rregullorja për Analizat e Tregut*), dhe nenit 13 paragrafi 1) dhe 5) i Statutit të (Ref. Nr. Prot. 054/B/17) të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*tutje referuar si; ARKEP ose Autoriteti*), Bordi Drejtues i Autoritetit në përbërje prej:

- 1) z. Kreshnik Gashi Kryetar
- 2) z. Nijazi Ademaj Anëtar
- 3) z. Hazir Hajdari Anëtar
- 4) z. Bahri Anadolli Anëtar
- 5) z. Shqiprim Pula Anëtar

në mbledhjen e 31-të me radhë të mbajtur me datë 20 Shtator 2018, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe rekomandimit të paraqitur nga Departamenti i Komunikimeve Elektronike (DKE) vendosi si më poshtë:

## VENDIM

- I. Vazhdohet procesi i analizës së tregjeve:
  - a) Qasjen në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse;
  - b) Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fiks;
  - c) Shërbimet telefonike nderkombetare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fiks;
  - d) Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruara në një lokacion fiks;

- e) Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fikse;
  - f) Shërbimet tranzite në rrjetet publike telefonike fikse;
- II. Procesi i analizës së tregjeve i përcaktuar me Vendimin nr.1194 (Ref. Nr.Prot.030/B/18) vazhdohet nga data **01 Tetor 2018** dhe përfundon më datë **31 Dhjetor 2018**.
- III. Obligohet Departamenti i Komunikimeve Elektronike që të zbatojë pikat I) dhe II) dhe t'ia paraqes Bordit të Autoritetit Draft Raportin së bashku me draft vendimet përkatëse nga procesi i analizës së tregut.
- IV. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

## **ARSYETIM**

Ligji, respektivisht neni 31 (*Analiza e tregut*), paragrafi 1) përcakton se procedura e analizës së tregut duhet të iniciohet me një vendim paraprak të Autoritetit. Po ashtu i njëjti nen, paragrafi 3.3) përcakton se Autoriteti ka të drejtë që të bëjë një analizë të tregut me vetiniciativën e tij.

Neni 31, paragrafi 3.3) i Ligjit përcakton se: *“Autoriteti ka të drejtë që të bëjë një analizë të tregut me vetiniciativën e tij.”*

Neni 31, paragrafi 8) i Ligjit përcakton se: *“Autoriteti duhet ta kompletojë procedurën e analizës së tregut brenda katër muajve pas vendimit të Autoritetit referuar në paragrafin 1. të këtij neni për inicimin e analizës së tregut. Autoriteti do t'i konsultojë palët relevante për draftin e vendimit të vet për rezultatet e analizës së tregut sipas procedurës e konsultimit për analizë të tregut e vendosur në nenin 82 të këtij ligji nuk do të përfshihet në kushtet e procedurës së analizës së tregut të referuar në këtë paragraf. Periudha për procedurën e analizës së tregut mund të vazhdohet me një vendim të arsyetuar të Autoritetit, por jo më shumë se tre (3) herë dhe jo më shumë se tre (3) muaj për çdo herë....”*

Rregullorja për Analizat e Tregut përcakton procedurat dhe principet bazë të procesit të përkufizimeve dhe analizës së tregut, përcaktimin e ndërmarrjeve me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) dhe imponimin e detyrimeve rregullatorë *“ex-ante”*, për të zgjidhur problemet e identifikuar të konkurrencës.

Neni 4 (*Përcaktimi i Tregjeve Përkatëse*) i Rregullores për analizat e tregut, paragrafi 3) ka përcaktuar si tregje të veçanta:

### **Tregjet me pakicë:**

- Qasjen në rrjetin publik telefonik në lokacione fikse;
- Shërbimet telefonike lokale dhe/ose kombëtare të disponueshme për publikun, të ofruara në lokacionin fikse;
- Shërbimet telefonike nderkombetare të disponueshme për publikun të ofruara në një lokacion fikse;

### Tregjet e Interkoneksionit:

- *Origjinimi i thirrjeve në rrjetin publik telefonik të ofruara në një lokacion fikse;*
- *Terminimi i thirrjeve për rrjete publike telefonike individuale të ofruara në një lokacion fikse;*
- *Shërbimet tranzite në rrjetet publike telefonike fikse;*

Autoriteti, me vendimin Nr.58 (Ref. ART Nr.Prot.31/01/2011), i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr.128 të datës 13/09/2011 (Ref. Nr.Prot.051/B/11) ka kryer analizën e tregjeve të telefonisë fikse të referuar më lartë.

Bazuar në nenin 3, paragrafi 13) të Rregullores për Analizat e Tregut përcaktohet se: *“Autoriteti duhet ta bëjë/rihikoj secilin treg nëse pritet që konkurrenca në atë treg ka ndryshuar, jo më pak se një herë në çdo tri (3) vite nga vendimi i kaluar përfundimtar i Autoritetit...”*.

ARKEP me Vendimin nr. 1194 (Ref. Nr.Prot. 30/B/2018; dt. 22/05/2018) ka inicuar procesin e analizës së tregjeve me pakicë dhe ato të interkoneksionit në rrjetet e telefonisë fikse nga data 01 Qershor 2018 deri më 30 Shtator 2018.

Megjithatë, proocesi i Analizës së tregjeve të referuar më lartë në njërin është mjaft kompleks në vetvete, jo vetëm për nga numri i madh tregjeve që trajtohen (gjithsej 6 tregje), por se tregjet të cilat janë objekt i kësaj analize gjithashtu janë të komplikuar për t’u analizuar, pasi që ndikohen nga faktorë të ndryshëm. Po ashtu kjo periudhë ka qenë me angazhime të mëdha për stafin e ARKEP në çështje të ndryshme.

Andaj, marrë parasyshë arsyetimet e mësipërme si dhe me qëllim të:

- Zbatimit të Ligjit, promovimit të investimeve dhe konkurrencës së lirë në tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Kosovës,
- Krijimit të kushteve dhe sigurimit të konkurrencës efektive në fushën e komunikimeve elektronike dhe parandalimit të shpërdorimit të fuqisë në treg nga ndërmarrësit me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT).
- Krijimit të sigurisë ligjore përmes përcaktimit të kornizës ligjore, rritjes së transparencës.

Atëherë është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Këshilla Juridike;**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit.

Prishtinë, 01/10/2018

**Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare**

**Kreshnik Gashi**  
**Kryetar i Bordit**

**Aktvendimi i dërgohet;**

- Ndërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike,
- Autoritetit Kosovar të Konkurrencës,
- Departamentit të Komunikimeve Elektronike, ARKEP
- Departamentit Ligjor, ARKEP; dhe
- Arkivit